



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiilanit
Opstina Gnjilane
Municipality of Gjiilan
Gilan Belediyesi

PROCESVERBAL

Nga procesverbali i mbledhjes së IV të Kuvendit Komunal e mbajtur me datë 26.03.2026 në ora 10:00 në objektin e SH.M.A.T. "Sahit Baftiu" në Gjiilan me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit dhe miratimi i procesverbali të mbledhjes së kaluar
2. Pyetje dhe përgjigje
3. Vendimi për miratimin e Planit të Punës të KK Gjiilan për vitin 2026
4. Vendimi për miratimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit dhe komiteteve obligative të KK –së për vitin 2026
5. Raporti i punës për vitin 2025 i kryetarit të komunës
6. Raporti financiar Janar-Dhjetor 2025
7. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronave të paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Kadrush Sylës nga Gjiilani, Lagjja Dheu i Bardh-Gjiilan
8. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Hisnije Halimi nga Zhegra
9. Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Nexhmedin Ibrahimimi nga Përlepница
10. Propozim për subvencionimin e dy familjeve strehuese alternative: Hakile Lutfiu nga Gjiilani dhe Aziz Hamdiu nga fshati Zhegër
11. Propozim për subvencionimin e punësimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Gjiilanit

2. Të ndryshme

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit

Përveç anëtarëve të kuvendit në mbledhje prezantuan: Elijesa Rashiti, Isa Agushi, Kushtrim Ibrahimimi, Haki Huruglica, Kadir Hysein, Enver Shabani, Elbasan Shabani, Bajram Isufi, Kushtrim Zeqiri, Mimoza K. Qerimi, Flakron Rexhepi, Abdyl Kastrati, mediat e shkruara dhe ato elektronike.

Mungoi: Arbër Ismajli.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e Kuvendit Krenare L. Kqiku e cila përshëndeti të pranishmit.

Krenare L. Kqiku: tani i thërras dy anëtarë të rinj të bëjnë betimin solemn si këshilltar komunal të këtij kuvendi.

Tani dalim te rendi i punës ku kërkoj që pika 10 largohet nga Rendi i punës gjithashtu ju njoftoj edhe për Raportin e kryetarit nëse jeni dakord që të hiqet nga Rendi i punës pasi që kryetari për arsye personale nuk mundet me qenë prezent në seancë. Unë kërkoj që edhe pika 5 të largohet nga Rendi i punës.

Gentrit Murseli: konsideroj që pikën e 5 të Rendit të punës Raporti i punës për vitin 2025 i kryetarit të komunës po e largojnë për një seancë tjetër mendoj se është e rëndësishme që të diskutohet me kryetarin e komunës edhe për raportin financiar të vitit 2025. Ne e kemi drejtorin i cili është emëruar për vitin 2026 edhe nuk kisha dashtë me i bart barrë të përgjegjesisë për vitin 2025 kështu që nëse anëtarët e kuvendit dakordohen kryetari i komunës raporton për raportin e punës për vitin 2025 nuk i pengon asgjë që të raportoj edhe për raportin financiar të atij viti kështu që propozoj që edhe Raporti financiar të shtyhet për seancën tjetër kur është prezent kryetari i komunës.

Shpend Nuhiu: pasi që i kemi të formuar komisionet e grupit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike propozoj që të hyn në rend ditës në pikën në të ndryshme Vendimin për caktimin e lartësisë së kompenzimit dhe e potencoj që nuk do të ketë ngritje por vetëm të lëshohet një vendim i ri me preambula të reja ashtu siç sekretaria e kuvendit më shpjegoi më herët.

Krenare L. Kqiku: atëherë me këto propozime unë kërkoj që një nga një të votohen.

Me 33 vota për pika 10 largohet nga Rendi i punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

Me 33 vota për pika 5 largohet nga Rendi i punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

Me 33 vota për miratohet vendimi për lartësinë e kompenzimit e anëtarëve të komisionit propozim nga Shpend Nuhiu.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

Me 14 vota për, 17 kundër pika 6 Raporti financiar Janar -Dhjetor 2025 propozim nga Gentrin Murseli mbetet në Rendin e punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

Me 34 vota për miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

Me 26 vota për miratohet Rendi i punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

2. Pyetje dhe përgjigje

Gentrit Murseli: dy çështjet e para të cilat dëshiroj ti potencoj sot kanë të bëjnë me përgjigjet të cilat i kërkoj nga kryesuesja e kuvendit.

Me datë 6 shkurt në cilësinë e anëtarit të kuvendit kam protokolluar dhe përcjellur për kërkesë zyrtare tek kryesuesja e kuvendit për fillimin e procedurave për ndarjen e çmimit qytetar nderi për doktorin e mirënjohur shqiptar Dr. Mentor Petrela.

Në cilësinë e anëtarit të kuvendit e kam protokolluar bashkë me dokumentin i cili e vërteton se kjo iniciativë është nga studentët gjilanas të cilët studiojnë në universitete të ndryshme shqiptare në shtetin shqiptar.

Unë në atë kërkesë kam potencuar se vetëm e kam protokolluar dhe kam kërkuar që diskutimet e mëtejme procedurale të jenë nëpërmjet kuvendit kryetarit të komunës dhe iniciatorëve të cilët janë studentët nga data 6 shkurt 2026 deri më sot nuk kemi marr asnjë përgjigje zyrtare dhe kisha dashtë që sot kryesuesja e kuvendit të më përgjigjet.

Gjithashtu ju njoftoj që kërkesa nga iniciatorët ka qenë që ky çmim ti ndahet doktorit të mirënjohur shqiptar me shënimin e datës ndërkombëtare Ditës Botërore të Shëndetësisë.

Nuk e di pse nuk janë marr procedura të mëtejme unë kam mujtë edhe me 12 nënshkrime të anëtarëve të kuvendit për ta vazhduar këtë procedurë por e kam cek edhe aty që nuk është iniciativë politike, partiake por është një iniciativë qytetare e cila duhet të përcjellet institucionalisht nga kuvendi dhe kryetari i komunës.

E dyta kërkoj sqarime nga kryesuesja e kuvendit lidhur me publikimet zyrtare të aktiviteteve të kuvendit nga Zyra e Informimit shpreh keqardhjen time për profesionistët e vërtetë të kësaj zyre që punën dhe angazhimin e tyre të palodhshëm e baltosin njerëz joprofesional dhe pa etikë pune duke keqpërdorur taksat e qytetarëve me të cilat kompenzohet angazhimi i tyre në këtë zyre sepse nuk është e drejtë nuk është korrekte që kur të zhvillohen seancat konstituive, solemne, seanca të rregullta të paraqiten vetëm ose të publikohen vetëm paraqitjet e anëtarëve të ekzekutivit mirëpo edhe anëtarëve të kuvendit të subjekteve të tjera që nuk janë në qeverisje duhet të jenë të barabartë në faqen zyrtare të informimit publik për qytetarët e Gjilanit.

Këto 2 çështje i kërkoj nga kryesuesja e kuvendit kurse çështja tjetër është një problematikë të paktën qe 2 vitet e fundit kisha dashtë me i falënderu publikisht drejtorët, kryetarin, kryesuesen dhe krejt ata që kanë marr pjesë gjatë këtyre ditëve në Qendrën për Sindromin Doën.

E kemi cek edhe në kuvend më herët po për shkak që ka pas fushatë elektorale viti i kaluar nuk kam dashur që në kuvend ta bëj çështje politike mirëpo zgjedhjet kanë përfunduar tani jemi 4 vite në kuvend edhe 4 vite në ekzekutiv problematikat të cilat i ka Qendra e Sindromit Doën janë esenciale, qendra funksionon në katin e 5 ku fatkeqësisht në të shumtën e rasteve nuk funksionon lifti dhe janë prindërit ata që detyrohen ti bartin fëmijët e tyre deri në katin e 5 për tju ofruar një shërbim ajo qendër për ta.

Përveç kësaj kisha dashtë nga drejtoresha e DSHMS ta bëj një sqarim në vitin 2025 është cek se ka mundësi që ish objekti i mjekësisë familjare në lagjen Arbëria të destinohet për njërën nga organizatat që merren me këto kategori ose të bëhet qendër e qëndrimit ditor për personat me aftësi të kufizuara.

Unë në këtë seancë e kam vetëm një kërkesë dëshiroj që ta di ky objekt i cili sot është i pashfrytëzuar në lagjen Arbëria a do të destinohet për Qendrën e Sindromit Down apo do të realizohet ai premtim elektorale i vitit 2021 që ka qenë nga ju.

Artan Cani: për drejtoreshën e DSHMS pse nuk po zhvillohen procedurat e rekrutimit për zëvendësimin e afër 10 punëtorëve në QKMF në Gjilan kur dihet që në mungesë të zhvillimit të procedurave çdo ditë Kosovën e lëshojnë çdo 4 ditë na ik një mjek prej Kosovës ose 1 infermier?

Malikie Hoxha: sot do ta ngris një çështje të rëndësishme vonesat në ndarjen e bursave komunale për studentët është një çështje që po shkakton shqetësim të madh.

Në tetor të vitit 2025 shumë studentë nga komuna jonë kanë aplikuar për bursa komunale i kanë plotësuar dokumentet dhe kanë pritur me shkresë.

Tani e dimë se jemi në fund të marsit 2026 dhe studentët nuk kanë marr ende asnjë përgjigje rreth këtyre bursave.

Dua ta theksoj qartë se kjo nuk është hera e parë që po ndodh, bursat e studentëve janë duke u vonuar për vite me radhë.

Kërkoj përgjigje të qartë pse po përsëritet kjo vonesë, ku po ngec procesi, kur konkretisht do të realizohen pagesat e aplikuesve të vitit 2025.

E kam edhe 1 pyetje për drejtorin e DSHPIB dua të ngris një shqetësim serioz që më është adresuar nga banorët e fshatit Cernicë sipas tyre punimet në trotuar dhe në këtë zonë kanë filluar tash e 2 vite dhe ende nuk kanë përfunduar për më tepër gjendja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit vazhdon të mbetet problematikë duke lënë pas vetes rrugë dhe trotualet të dëmtuara të pasigurta dhe vështirë të kalueshme për qytetarët.

Sa i përket ujësjellësit sipas banorëve të Cernicës ka ekzistuar një rrjet i kompletuar pothuajse në tërë fshatin ku kanë qenë të kyçura 260 shtëpi, gypat ekzistues nuk janë larguar por i kanë vendosur gypat e rinj ndërsa shumica prej tyre janë dëmtuar.

Pavarësisht këtij investimi ende nuk është funksionalizuar dhe banorët vazhdojnë të mbesin pa furnizim me ujë ndërkohë trotualet vazhdojnë të jenë të prishura duke ua vështirësuar jetën e përditshme qytetarëve sidomos këmbësorëve, fëmijëve dhe të moshuarve.

Pse janë zvarritur këto punime kaq gjatë?

Pse rrjeti i ri nuk është funksionalizuar?

Kush mban përgjegjësi për këtë gjendje, kur do të përfundojnë trotualet dhe të funksionalizohet ujësjellësi?

Kushtrim Kadriu: kam 1 pyetje për drejtoreshën e DSHMS dua të di se a ka marr ndonjë raport nga Shoqata të cilat i kemi ndihmuar ne si kuvend, nëse po atëherë kërkoj që këtë raport të na shpërndan neve si këshilltar komunal që e kemi votuar në të kaluarën dhe gjithashtu kam disa kërkesa për kryesuesen e kuvendit.

Kërkoj që të iniciohet procedura e paisjes së këshilltarëve komunal me IT me karta identiteti si dhe kërkoj funksionalizimin e zyrës së asambleistëve për kuvendin komunal.

E dimë se e kemi pas një zyre dhe kërkoj që këshilltarët komunal të jenë sa më afër dhe më aktiv më afër qytetarëve.

Sami Ahmeti: pyetja ime është ka filluar ndërtimi apo shpenzimet për mirëmbajtjen e objekteve banuese në Gjilan në raport financiar kam pa një shpenzim enorm që është shpenzuar për këto objekte.

A mundeni të na tregoni cilat objekte janë rinovuar ?

Është filluar një banim një banesë për bonus banim në Porodin ky kuvend atë parcelë më herët e ka nda për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.

Ajo parcele tash ju ka ndërruar destinacioni qysh është bërë ky ndërrim i këtij destinacioni kur ajo parcelë është nda për familjet e dëshmorëve?

Për drejtoreshën e DSHMS kur fillon kontrollat sistematike dhe a ka ndonjë plannuk është dëgjuar në fund diskutimi.

Bujar Nevzati: kryesuese po të falënderoj që ke marr iniciativë që nga ky objekt në seancat e ardhshme do të vazhdojmë në një vend ku e meritojnë këshilltarët e kuvendit komunal prandaj dhe po të falënderoj.

Edhe po kërkoj që mundësisht stafit tuaj që ku edhe atë ditë biseduam që patëm takimin ti sigurohet edhe një zyre aty pranë ku unë besoj se ka mundësi të bëhet një zgjidhje.

Po e jap një vërejtje kryetari sot nuk është dhe mos të vazhdon kryetari mos me ardhën nëpër seanca e mandej në fund me akuzu që opozita nuk po e dëgjon raportin

Kjo nuk është e mirë sepse është fillimi i mandatit dhe nuk është mirë të ndodh kjo.

Për drejtorin e DSHPIB kam disa pyetje për drunjtë e mbjellur para disa viteve disa janë rritur shumë dhe shikoni disa mbrojtëse që kanë mbet aty, pse nuk po ndodh kjo që të hiqen nga aty?

E kam ngrit çështjen e gomave të vjetra është e disata herë që është premtuar që do ta gjeni vendin me komunat fqinje por deri më sot nuk ka ndodhur. A ka ndërmarr diçka DSHPIB ?

Disa institucione komunale përfshirë shkollat, teatrin, biblioteka vitin e kaluar edhe tash kanë mbet pa lëndë djegëse mirëpo janë disa kompani që po ju dërgojnë, në çfarë forme po ju dërgojnë, unë e di që ata nuk kanë mjete?

Pse nuk po i jipni numrat e adresave të qytetarëve për arsye se ka disa biznese për shkak të numrit munden me ndryshu biznesin ?

Për vërshimet e fundit që kanë ndodh në seancën e kaluar e morëm një vendim kur do të fillojnë qytetarët që ti marrin apo t'ju rregullojnë pasojat e shiut?

Fitim Guda: kisha pas një kërkesë që po i humb sensi demokracisë kryetari duhet të jetë këtu, e di që nuk është me ligj obligative por veç në atë formë që mundemi të komunikojmë me kryetarin që ti paraqesim gjithë shqetësimet tona prandaj i bëjmë apel kryetarit që të jetë në seanca të tjera. Për drejtorin e DSHPIB shohim çdo ditë në qytet të Gjilanit rrugë që po hapen prap, po prehen për ca kanalizime, për ca investime.

Si qytetar po pyes jo si këshilltar komunal e kam të qartë se qysh është e mundur që paraja publike të jetë ashtu e destinuar për keqpërdorime.

Para 3 muajve janë shtruar rrugët dhe pas 3 muajve shikoni gjendjen faktike (tregon fotot), kjo është gjendja e rrugëve të prera prandaj pyes drejtorin a kemi ndonjë titullar, ndonjë person i cili e menaxhon këtë situatë, si është e mundur që para 3 muajve i shtrojmë rrugët i bëjmë vijëzimet dhe pas 3 muajve prap ato rrugë të njëjta hapen?

Për drejtorin e DI po më intereson kush ka dhënë leje edhe kush e ka aprovuar kërkesën e Viva Freshit në rrugën e ish Halim Orana e cila gjendet në larg përçuesin e tensionit të lartë ku aty 30 punëtorë çdo ditë janë nën ndikim të rrezeve magnetike, të rrezeve të cilat mund të rrezikojnë shëndetin e tyre.

Drejtor të lutem me ndërmarr masa tilla me dal në vend ngjarjes me shiku njëkohësisht shikoni gjendjen kaotike si e keni sjell lagjen ku është dhënë leja për Viva Freshin?

Muhadin Haziri: për drejtorin e DMSH kisha kërkuar që në vitin 2025 ish drejtori në lidhje me pastrimin e lumit Karadakut në Zhegër ka mbet edhe një pozicion i cili po krijon vështirësi sidomos nga tereni aty po e quaj nga ura e Behxhet Pacollit deri te ura e fshatit Selishtë.

Aty shumë biznese kanë pas probleme dhe pasoja rreth nivelit të lumit Karadakut në Zhegër unë shpresoj se kërkesa në emër të këshillit të fshatit është për vitin 2025 të njëjtën kisha kërkuar ta paraqisni në nivelin qendror në kuadër të kodeve buxhetore të cilat edhe ministria i ka nda për rastet më emergjente që janë.

Për drejtorin e DSHPIB për nismën e punimeve të rrugës së Kumanovës e cila do të del te ura ekzistuese që lidhet për Zhegër?

Për drejtorin e DBP kisha kërkuar që konform buxhetit të planifikuar për vitin 2026 sidomos rruga në Zhegër që është vend i fushës bujqësore kërkoj që së pari të bëhet hapja e kanalit për trajtimin e ujërave të shiut e cila del në dalje në fshatin Nasalë dhe i njëjti kanal zbrazet në lumin Morava?

Besnik Shala: për drejtorin e DBP për qentë endacak ku është si trajtim dhe për drejtorin e DI të uroj për vullnetin dhe gatishmërinë për pastrimin e atyre barakave në shesh?

Fadil Ademi: rruga prej ETC-së deri në Velekincë e di që është planifikuar të rregullohet mirëpo po zhagiten nga ana e operatorëve dhe pyetja e dytë ka të bëjë me fshatin Kokaj rrugë që pritet të asfaltohet dhe ka mbetur në gjysmë?

Kushtrim Ibrahim-DSHPIB

Për fshatin Cernicë për shqetësimin e banorëve në atë pjesë të fshatit aty ka qenë një kontratë e cila është nga Hidromorava dhe bashkë financim edhe me ministri atëherë punimet aty kanë filluar edhe për shkak që janë shfaq për disa probleme të tjera nga operatorët e Hidromoravës dhe për shkak terreneve që janë aty edhe ka pas ankesa të banorëve mirëpo në bashkëbisedim dhe me takimet që i kemi pas me Hidromoravën në këtë vit ata po shpresojnë që shumë shpejt me i rifillu punimet me operatorin që ka qenë duke punuar aty.

Sa i përket drunjve mirëmbajtjen e tyre e bëjnë punëtorët e Ndërmarrjes Tregu edhe me ta jemi thuajse në kontakt ose javor ose ditor kanë filluar këtë javë rreth prerjes së drunjve.

Aty është në kompetencë të Tregut sa i përket mirëmbajtjes së krasitjes së tyre dhe ujitjes së tyre mirëpo ne si drejtori e kemi iniciuar edhe një kontratë për mirëmbajtjen e parqeve ku patjetër që edhe ne do të investojmë në ato problematika që na shfaqen gjatë kësaj periudhe dhe kur e

kuptojmë që jemi në fazën e pranverës nevojitet krasitja e tyre në bashkëpunim me Tregun kemi filluar gjatë kësaj jave për krasitjen e drunjve sa i përket komunës tonë.

Me marrjen e mandatit të ri si drejtori kemi pas takime edhe me mbledhje të bordit por edhe me drejtoreshën e DGJKP-së dhe DUPMM-së ku ne kemi kërkuar nga ata që të na jipet një parcelë e cila do të jetë në shfrytëzim edhe për këto pyetjet e juaja direkte për gomat të pashfrytëzuara mirëpo kemi kërkesa të mëdha sa i përket mbeturinave inerte ku jemi duke u munduar që të gjejmë një vend adekuat të posaqëm ku besoj se shumë shpejt do ta zgjidhim këtë problematikë duke pasur parasysh që kemi edhe kërkesa të mëdha nga qytetarët sidomos kur bëhen edhe renovimet e shtëpive ose objekteve është një shqetësim shtesë për komunën tonë.

Për prerjen e rrugëve që janë duke ndodh në qytetin tonë sidomos në zonën urbane sa i përket kësaj problematike ne jemi thujse në teren gjatë gjithë kohës me zyrtarët e tonë i kemi nja 3 kontrata aktive që janë të Hidromoravës kontrata e parë që është më madhore dhe më e rëndësishmja për komunën tonë është impianti i ujërave të zeza kur e kuptojmë që kjo temë ka qenë thujse më shumë së 10 vite ose 15 vite në qytetin tonë ku tash më në fund është nënshkruar ajo kontratë në vitin e kaluar kanë filluar punimet nga operatori ekonomik ku ata e kanë për obligim ku rrugët që dëmtohen ti kthejnë në gjendje të mëparshme.

Kompanitë janë serioze dhe jemi duke e bërë një mbikqyrje mbrapa tyre mirpo punimet janë duke u zhvilluar.

Ne e kuptojmë si problem si shqetësim për arsye se nuk është vetëm një kontratë e impiantit të ujërave të zeza por i ka edhe 2 kontrata të tjera Hidromorava.

Rrugës së Kumanovës si problematikë është thujse e kahmotshme edhe kjo kurse ka filluar deri më tani aty i kemi disa probleme sa i përket pronave në pjesën e Pisjanit që e kap pjesën e Budrikës ku aty kemi biseduar edhe me ish drejtorin e DGJKP-së vitin e kaluar.

Këta e kanë shpreh gatishmërinë dhe vullnetin që me ju ndihmu atyre sa i përket parcelave sepse ata po arsyetohen me mungesë të stafit por edhe ka një lloj mungese të mos bashkëbisedimit me neve për të bërë ndonjë marrëveshje konkrete edhe pse ne kemi kërkuar disa herë që tju ndihmojmë edhe me zyrtarë tanë që të kryhet sa më shpejt ajo procedurë.

Në kontratën që është e kryer dhe e tenderuar ne e kemi kryer pjesën e soliterit ku e kemi gëlqeros pjesën e jashtme dhe takimin që e kemi pas me banorët janë nda shumë të kënaqur po besoj se do të vazhdojmë edhe me pjesë të tjera ku i kemi në plan si drejtori.

Sa i përket rrugës së Arbërisë nga ETC-ja që u cek aty poshtë është e vërtetë që e kemi pas një memorandum me ministrinë e infrastrukturës.

Operatori ekonomik ka filluar në disa pjesë të fshatit në Velekincë sa i përket sanimit dhe trajtimit të trotuareve mirëpo momentin që ne kemi tentuar të fillojmë pjesën e asfaltit njëra prej tyre është prej ish zyrës së kryetarit diku 2 km deri në fshatin Velekincë.

Unë e kam edhe një kërkesë sa i përket kuvendit në plan të punës nuk i kemi pa kërkesat e drejtorisë sonë dhe nëse është e mundshme të përfshihen edhe kërkesat tona.

Mimoza K. Qerimi- DSHMS

Për procedurat e rekrutimit së paku deri javën tjetër më se largu deri në fund të javës tjetër fillon procedura e rekrutimit për staf mjekësor dhe për gjitha ato nevoja që janë momentale.

Edhe kontrollat sistematike janë bërë të gjitha planifikimet me kohë dhe mendojmë të fillojmë gjatë muajit maj-prill dhe nëse ju intereson plani janë të parapara shkollat fillore, çerdhet, si ato publike dhe ato private.

QKMF në Lagjen Arbëria është dhënë në shfrytëzim fondacionit dhe Hendikepit për një kohë të caktuar deri në vitin 2025 dhe ajo kohë ka përfunduar meqë objekti tash është në pronësi të

komunës me kërkesën e Doën Sindrom Kosova në takim që ishim me kryetarin ju premtoi se do të jipet në shfrytëzim për nevojat e tyre sepse i plotëson kushtet dhe përkohësisht objekti ka nevojë për riparim dhe për këtë pjesë kryetari ju ka premtuar se do ti bëjë me kontrata të mirëmbajtjes renovimin e gjithë objektit dhe përkohësisht ata do të dalin aty kurse sa i përket qëndrimit ditor është edhe zotimi i kryetarit që do ta bëjë një qendër të kujdesit ditor ku është jashtëzakonisht i interesuar dhe i përkushtuar që sa më shpejt të filloj ku është në kërkim të donatorëve.

Isa Agushi-DI

Unë kam filluar detyrën prej 23 shkurtit të këtij viti nuk jam përgjegjës për objektin e Vivës. E kam vetëm një informacion që nuk ka pasur operator në atë kohë për rrënim. E dyta jemi duke punuar për hapësirat publike për çdo ditë është mirë që edhe njerëzit e juaj të bashkëpunojnë me neve rreth hapësirave publike.

Bajram Isufi-DBP

Në këtë vit kemi projekte, kemi për rrugët fushore por për shkak të vërshimeve që kanë ndodhur kemi shumë dëme nëpër rrugë fushore kështu që shpresoj me bartje të buxhetit të rritet buxheti, ti riparojmë dhe ti japim rrugë.

E njoh rrugën që e potencove ku shpresoj se do ta kryejmë.

Për qentë endacak ne kemi projektin është projekt 3 vjeçar deri më tani janë trajtuar 335 qenë ku ju është bërë një analizë e cila është për sëmundjet infektive dhe është në rrezik për njerëzit ku për fat të mirë analiza është dal mirë dhe projekti vazhdon.

Krenare L. Kqiku: atëherë me sa kam marr unë shënime edhe 1 pyetje e kemi pas për drejtorin e DMSH, meqenëse drejtorin nuk po e shoh këtu besoj se do tju përgjigjet me email adresë.

Fitim Guda: drejtorin e falënderoj për përgjigjen unë nuk po bëj politikë por si qytetar po flas se është e dhimbshme ta keni një trup koordinues mes jush dhe Hidromoravës dhe mes kësaj kompanisë tjetër është e dhimbshme pas 3 muajve asfalti i shtruar pa projekt. Unë mendoj se duhet të ndërmerri diçka që në të ardhmen mos të ndodhin.

Bujar Nevzati: dy përgjigje nuk i mora për vërshimet dhe numrat edhe drejtorit i them miqësisht nise fillo hera e tretë që thuani për gomat të njejtën përgjigje. Te drunjtë dil të hënën i merr punëtorët e Tregut për 4 orë i hiqni të gjitha ato që në seancën e ardhshme mos të vimë prapë me të njejtën gjendje.

Kushtrim Ibrahim-DSHPIB

Sa i përket asaj rruge te Avdullah Presheva ne me të vërtetë jemi në koordinim shumë të mirë me Hidromoravën mirëpo aty ka qenë një moskoordinimi sa i përket një lejes së Kedsit ku ata nuk na kanë paralajmëruar me kohë por aty fatmirësisht e kemi edhe një shtresë të dytë të asfaltit ku çdo dëmtim apo sanim është nën përgjegjësinë e tyre ku ne shumë shpejt do ti rifillojmë punimet sa i përket pjesës së dytë të asfaltimit të rregullimit të ndriçimit të trotuarit dhe pjesës së ndriçimit. Sa i përket pyetjes së Bujarit DSHPIB ka bërë kërkesë edhe në DGJKP dhe në DUPMM dhe sa i përket procedurave të PZHK-së këta janë duke tentuar të hyn në PZHK dhe në momentin që këta i kryejnë punët e obliguara si drejtori ne do të merremi me pjesën tjetër.

Krenare L. Kqiku: para se të fillojmë me pikën e radhës unë ndjej obligim që tju përgjigjem Gnitrit dhe z. Nevzatit për ti falënderuar për mbështjetjen rreth iniciativës sime për seancën që është diçka që duhet me ndodh ku jam e bindur se do të ndodh shumë shpejt.

Gentrit iniciativa jote do të ndodh shumë shpejt unë me datën 10 e kam marr kërkesën tuaj ku është e vërtetë që nuk keni marr asnjë përgjigje se askush nuk është kundër kësaj kërkesë por besoj se shumë shpejt do ti vjen radha kësaj kërkesë ku do ta shqyrtojmë së shpejti.

Unë nuk besoj se dikush ka me qenë kundër dr. Petrelës ku ne jemi në fillim të mandatit po punojmë edhe me komisione sepse kërkesa ka ardhur prej jush ju keni mujtë me i mbledh edhe 12 nënshkrime prej asambleistëve kërkesa që është protokoluar në QSHQ me iniciativën e studentëve që e kanë marr me rregullore unë e di që i duhen mbi 2000 nënshkrime për ti siguruar ;por për të mos e kërkuar iniciativën e studentëve që ti grumbullojmë 2000 nënshkrime ne mundemi si anëtarë të kuvendit me 12 nënshkrime ta shtyejmë para.

Sa i përket Zyrës së Informimit unë i kam pa ankesat e juaja përmes portaleve ku mendoj se është mirë ti adresoni te Zyra e Informimit ku mendoj se nuk është bërë e qëllimshme ku unë i kam pa edhe anëtarët e grupeve tjera.

3. Vendimi për miratimin e Planit të Punës të KK Gjilan për vitin 2026

Me 23 vota për, 1 abstenim, miratohet pika 3 e Rendit të punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

4. Vendimi për miratimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të kuvendit dhe komiteteve obligative të KK –së për vitin 2026

Me 28 vota për miratohet pika 4 e Rendit të punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

6. Raporti financiar Janar-Dhjetor 2025

Abdyl Kastrati-DBF

Buxheti fillestar për vitin 2025 ishte 37.189.018,00 € ndërsa buxheti përfundimtar pas përfshirjes së mjeteve të bartura të hyrat vetanake donacioneve ka arritur vlerën 41.375.005, 32 €.

Nga ky buxhet janë realizuar shpenzime në shumën prej 39,364,215.89 që përfaqëson një nivel të realizimit prej 95.14 të buxhetit të planifikuar që reflekton një menaxhim të qëndrueshëm dhe të disiplinuar financiar.

Sa i përket të hyrave vetanake janar-dhjetor për vitin 2025 planifikimi ka qenë në vlerë prej 5.038.508,00€ ndërsa realizimi ka arritur në shumën një normë prej 75 %.

Ky tejkalim i planifikimit reflekton një performancë të lartë në inkasimin e të hyrave vetanake si dhe një angazhim të shtuar institucional në forcimin disiplinimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shumë mekanizmave të mbledhjes së të hyrave.

Gjithashtu duhet të theksohet se në vitin 2025 menaxhimi i buxhetit është zhvilluar në rrethana të veçanta institucionale për shkak të procesit zgjedhor dhe vonesës së miratimit të buxhetit për këtë

vit komuna ka funksionuar sipas rregullit të financimit të përkohshëm pra të vitit 2024 sipas ligjit në fuqi.

Gentrit Murseli: kjo pyetje ka qenë e destinuar për kryetarin e komunës por meqenëse bashkëpartiakët e tij kanë vendos që këtë çështje me mbajtën tash në seancë dua një përgjigje nga drejtori.

Qysh ka mundësi që një komunë në vitin 2025 i ka të planifikuara investimet kapitale 19 milionë euro 15 projekte nuk arrin asnjërin prej 15 projekteve të vitit 2025 me i realizu pra të gjitha janë në proces të prokurimit asnjë i përfunduar jo vetëm të vitit 2025 por kemi projekte edhe të vitit 2024 që nuk keni arritur ti realizoni në vitin 2025.

Meqenëse ne investime kapitale nuk po mundeni ti përfundoni projektet madhore e kam fjalën për projekte të mëdha.

A ka dikush përgjegjësi rreth kësaj çështjeje?

Ju e keni cek që shërbime të veçanta dhe për kontraktor individual keni me i pagu shpenzimet prej DBF-së 2 milionë e 800.000€ me pagu për shërbime të veçanta dhe për kontraktor idividual?

Për çfarë shërbime i keni pas gjithë këto mjete financiare dhe si është e mundur që për 1 vit mos me mujtë të përfundoni asnjë investim kapital?

Riad Rashiti: ky raport për mua vazhdon të jetë shqetësim serioz, mungesa e kryetarit të komunës sepse edhe në vitin e kaluar s'kam qenë anëtar i kuvendit komunal por e di që nuk i ka raportuar kuvendit komunal një raport financiar poashtu nuk i ka raportuar as për raportin e auditorit të përgjithshëm që ka gjetë dhe ka konstatuar shumë shkelje të rënda ligjore dhe financiare për vitin 2024, e që realisht viti 2025 pritet të jetë edhe një gjendje edhe më alarmuese, edhe më shqetësuese jo vetëm për komunën e Gjilanit, për qytetarët për krejt ata që kanë marr përgjegjësi me përkrah një planifikim të tillë buxhetor çfarë ka qenë në vitin 2025 dhe mënyra qysh është shpenzuar ai buxhet në vlerë prej 41.375.005,32€.

Unë e di që drejtori i buxhetit tani e ka marr përgjegjësinë e ka problem të jep përgjigje në shumë çështje të rëndësishme që duhet sot me i pas ne si përfaqësues i qytetarëve në kuvendin komunal por një gjë më ra atë që e tha vet konstatimi mbi 9 milionë euro janë paguar vitin e kaluar për vendime gjyqësore.

E di që pyetja tjetër ishe sa ishin shpenzimet të kamatave, të procedurave gjyqësore, të shpenzimeve të ndryshme dhe sa ka humbur komuna e Gjilanit, sa ka pësuar qytetari i Gjilanit nga keqmenaxhimi i tmerrshëm financiar të cilin e kemi thënë edhe viteve të kaluara, e kemi thënë edhe vitin e kaluar edhe sivjet kur është miratuar buxheti.

Po planifikohet krejt diçka tjetër, planifikohen projekte të shumta kapitale në realitet përfundon viti dhe as nuk nisin as nuk përfundojnë.

Buxheti shpenzohet 41.375.005,32€ në vendime gjyqësore, në anarki të plotë të projekteve dhe ky kaos që po ndodh në Gjilan vërtetë ka të drejtë plotësisht kryetari i komunës që i ik ballafaqimit të tij këtu në kuvendin komunal ashtu siç i ka ik vitin e kaluar por unë besoj se të kemi shëndet të gjithë bashkë edhe ai edhe ne gjithë, kemi me pas seanca të tjera dhe nuk do të mund të i ik raportit të punës së tij.

Kurdo që vjen kemi me i ballafaquar argumentet të cilat ai duhet të jep llogari, ka me pas raporte auditori që do të vjen në maj e qershor prape dhe nuk ka me mujtë me i ik sepse ikja ka me pas një fund dhe dëmet që i ka shkaktuar veprimet e tij të jashtëligjshme ka me ardhën dita që do të jep llogari edhe para shtetit edhe para zotit.

Drejtor të uroj me pas qëndrueshmëri profesionale në punën tënde sepse vitin e kaluar janë ndërruar 3 drejtor.

Kur po them qëndrueshmëri profesionale po them që të kryeni punën tënde pa ndikime dhe pa presione që kanë vazhduar gjithmonë prej ekzekutivit të komunës gjegjësisht prej kryetarit të komunës.

Të lëshohem në shifra ka shumë për të folur në parregullësi ka shumë për të folur pyetje mund të bëni sa të doni drejtorët janë këti ata që e kanë qenë në mandatin e kaluar kanë përgjigje por përgjigjet janë të njëjta dhe ato janë gjysmake, po themi të paqëndrueshme sepse nuk kanë guxim me thënë të vërtetën për ato dukuri shqetësuese që kanë ndodhur me buxhetin e komunës.

Unë këtu e kam një listë të projekteve që i ka raportuar drejtori për investimet kapitale të vitit 2025, janë projekte që kanë qenë të planifikuara në shuma ka shumë por disa dua ti theksoj dhe ato planifikime janë shpenzuar në krejt diçka tjetër dhe për këtë është mirë drejtori i DSHPIB me na tregu se ky e di më së miri .

Ka qenë në mandatin e kaluar së paku 2 vitet e fundit edhe është edhe sot ku dua të marr përgjigje prej drejtorit të DSHPIB-së sepse drejtori i Financave nuk e ka këtë mundësi të përgjigjet.

Janë dhjetëra projekte që kanë qenë të planifikuara por nuk janë realizuar dhe janë shpenzuar për projekte tjera kapitale apo për mallra dhe shërbime sepse janë mbi 9,000,000€.

Unë e di që arsytimi përherë ka qëndruar nga qeverisja e trashëguar dhe kanë qenë borxhe e di që qëndron një pjesë e arsytimit por një pjesë e arsytimit qëndron se shpronësimet e tokave që vinë edhe ajo qëndron që ne e quajmë shpeshherë obligime kontigjente që nuk dihet kur bëhen reale dhe ka me ardhën një moment që komuna e Gjilanit do ti paguaj edhe ato obligime.

Por shumica e buxhetit prej 9,000,000€ kisha dashtë prej drejtorit të buxhetit nëse e ka këtë përgjigje ose prej drejtorit të DSHPIB-s

Sa është shuma e kësaj 9 milionë euro që janë paguar për shpronësime dmth vendime gjyqësore për shpronësime, sa janë për obligime që kanë dal nga kontrata kolektive dhe sa milionë euro janë shpenzime që janë bërë për projektet kapitale që ju ka ndërruar destinimi.

Psh po i përmendi disa kanë qenë të destinuara ndërtimi i rrugëve në lagjen Dheu i Bardhë 83.000 € ndërsa janë paguar për mirëmbajtje teknike të objekteve 21.000€, ndërtimi dhe rikonstruktimi i rrugës Adem Jashari që nuk ka përfunduar ashtu siç ka qenë i planifikuar prej 149,000,000€ janë shpenzuar për diçka tjetër për mirëmbajtje teknike të objekteve 149.000 €, ndërtimi i rrugëve në fshatin Dobërqan 34.222 € janë paguar mirëmbajtje teknike të objekteve, ndërtimi i rrugëve në fshatin Cernicë 33.000€ janë shpenzuar për mirëmbajtje teknike të objekteve, ndërtimi i rrugëve në fshatin Bresalc në vlerë prej 24.000€ janë shpenzuar për mirëmbajtje teknike të objekteve, ndërtimi i rrugëve në fshatin Kmetovc poashtu është shpenzuar për mirëmbajtje teknike të objekteve, planifikimi për ndërtimin e rrugëve shtesë në fshatin Malishevë prej 15.000€ është shpenzuar për diçka tjetër për kompensimin e mësimdhënësve, për ndërtimin e rrugës në fshatin Zhegër dhe në Bilinic poashtu janë shpenzuar për vendime gjyqësore të destinuara për diçka tjetër, ndërtimi i trotuarit në fshatin Llashtic në vlerë prej 25,000€ është shpenzuar për transportin e tifozëve të klubeve sportive në rregull edhe kjo por kjo ka qenë e planifikuar te mallrat dhe shpenzimet, ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse 130,000€, në Fidanishte është shpenzuar për ndërtimin e ujërave në fshatin Demiraj, Gumnisht, Verbicë, Livoq i Epërm, ndërtimin e rrugës në afërsi të kolegjit Gjilani.

Të planifikuar për Fidanishte janë shpenzuar për diku tjetër, shpenzohen te planifikimi në Bulevardin e qytetit të Gjilanit janë shpenzuar 750,000€ .

Ne nuk kemi qenë kundër vitin e kaluar por e kemi ditë që nuk kanë me u zbatu prandaj shumë projekte të cilat ne i kemi kundërshtuar vitin e kaluar si PDK nuk kanë qenë që kemi qenë kundër

investimeve por kemi qenë kundër sepse është pa dhe është ditë që kanë me mbet dhe nuk kanë me mujtë me u nis dhe ka me ndodh kjo që ka ndodhur.

Krejt janë marr për qëllime tjera dhe janë marr për vendime gjyqësore me kosto shtesë dhe me humbje buxhetore që i kanë ndodhur komunës së Gjilanit, rregullimi i platosë të hapësirave të gjelbëra për lumin Mirusha 100.000 € janë shpenzuar për projekte të tjera kapitale, rregullimi dhe funksionalizimi i fshatit të lumtur 100.000 € që 3 vite ndahet buxhet dhe planifikohet dhe asnjë cent nuk shpenzohet për këtë projekt.

Te projekti i hapjes së traseve në fshatin Zhegër, Isufaj, Sefer dhe Shurdhan 180.000 € është shpenzuar 80.000 € për mirëmbajtjen teknike të objekteve.

Unë e kuptoj sa qindra mijëra euro dhe sa kanë qenë ato shpenzime që i kanë bërë për mirëmbajtjen e objekteve teknike, është mirë me ditë çka ka ndodhur me këto pagesa po flasim për gjysmë milioni € së paku.

Ndërtimi i AMF-së në Fidanishte që 3 vite planifikohet dhe nuk ka nisur fare dhe është paguar 52.000€ prap është shuma për mirëmbajtje të objekteve teknike.

Tabelat digjitale në shkollat e Gjilanit drejtori është këtu ish drejtori i DKA-së 128.000€ nuk janë shpenzuar për këtë por prap për mirëmbajtje teknike.

Të hollat që kanë qenë të destinuara për tabelat digjitale i keni shpenzuar për mirëmbajtje unë nuk po i kuptoj këto shpenzime kaq të mëdha për mirëmbajtje, ndërtimi i terenit sportiv Agim Ramadani në Zhegër 60.000€ të ndara poashtu është shpenzuar për mirëmbajtje teknike të objekteve, ndërtimi i fushës sportit me bari sintetik në shkollën Nazmi Hikmet në fshatin Dobërzan 20.000€ poashtu është shpenzuar për mirëmbajtje teknike të objekteve, ndërtimi i fushës së sportit dhe këndi i lojërave për fëmijë në fshatin Bresalc edhe ky buxhet prej 60.000 € është shpenzuar për mirëmbajtje teknike, paisje shkollore 49.960€ edhe ky buxhet është shpenzuar për mirëmbajtje teknike.

Projekti 200.000€ për ndërtimin e Qendrës memoriale Kodra e Dëshmorëve 200.000€ është shpenzuar për mirëmbajtje teknike të objekteve, 1,000,000€ kanë shkuar për mirëmbajtje teknike të objekteve.

2,000,000€ 778,000 + 732,000 shpenzime kontraktuese tjera të dyja këto bëjnë 2,500,000€ e dini se ku janë shpenzuar këto në fushatë elektorale të vitit 2025 sepse kanë qenë 3 palë zgjedhje, keni punësuar qindra e qindra.

Isha duke thënë që 3,500,000 janë shpenzuar për kontrata në vepër, në punësimet e militantëve dhe atyre që i kanë shërbyer për blerje të votës gjatë vitit 2025.

3 palë zgjedhje 3 herë janë blerë votat dhe kjo është e konstatuar por e prisni raportin e auditorit të përgjithshëm dhe këto që po i them unë janë të argumentuara dhe ne si opozitë ju siguroj që nuk kemi me hesht dhe do ti adresojmë çështjet ku vjen momenti që keni me dhënë llogari edhe para qytetarëve edhe para ligjit.

Në fund i kam 3 pyetje për drejtorin e DBF:

1. Sa është shpenzimi i buxhetit në përqindje dhe shumë të vitit 2025 për projektet kapitale, sa kanë qenë të planifikura dhe sa janë realizuar?
2. A është transferuar buxheti nga ministria për tatimin në pronë që e kanë falur për vitin e kaluar 100 € që ka qenë për tatim pagues?
3. Pse nuk është ardhur propozimi për bartjen e mjeteve të pashfrytëzuara të vitit të kaluar i vitit 2026 sepse sa herë ka ardhur në mars për ti kryer obligimet që ka komuna?

Nazim Gagica: e para një lajm i mirë është që po ndërrohet ky ambient e po dalim në një vend tjetër por i kotë është që ky debat që ne sot e zhvillojmë këtu lidhur me buxhetin dhe kuletën e komunës kur kemi mungesë të skajshme të transparencës.

Në anën tjetër në mungesë të transparencës mandej bëhet filtrimi i informimit publik pra krejt opinionin publik sot na sheh përmes asaj kamerës së sigurisë.

Paramendoni kamera e saj nuk plotëson kushtet dhe kriteret as për siguri e mos të flasim për transmetim publik.

Uroj që në të ardhmen nëse nuk zgjidhet ky problem ne ta zgjidhim vet problemin e transmetimit publik ose secili prej nesh ti marrim ekipet tona këtu dhe tja prezantojmë saktë qytetarit edhe të mirat e qeverisheshës por edhe defektet e dëmet që bëhen.

Sot po flasim për buxhetin e vitit 2025 dhe në vitin 2025 a ju kujtohet kur jemi ballafaquar me refrenin e zakonshëm po na mungojnë 2,000,000€ nuk po na i përkrah opozita permanent i kanë kërkuar bartjen e mjeteve prej 2,000,000 eurove dhe tash del që 2,000,000€ kanë tepruar në buxhetin e vitit 2025 janë të pashfrytëzuara.

Do të thotë ka qenë një zhurmë kot e bërë në vitin 2025 sa për kamuflim.

I përmendën kolegët e mi defektet për zërat financiar unë do të ndalem veç te një pikë ajo që ka të bëjë me planifikimin.

Ose nuk është ditë të planifikohet buxheti ose qëllimshëm është planifikuar me humbje dhe ju që jeni ekonomist dhe ju të tjerat e dini sepse janë gjëra të dukshme.

Në vitin e realizimit janar-dhjetor të vitit 2024 është 5 milionë 619,000€ planifikimi për vitin 2025 bëhet me ulje me 5,000,000 e diçka.

Qysh ka mundësi një planifikim të bëhet me ulje, ky planifikim me humbje e dini kur ndodh në situatat e jashtëzakonshme, në përgatitje për luftë, në kohë pandemie por në rrethana normale keni caktuar një minivlerë të caktuar në vitin paraprak dhe planifikon humbje kjo nuk do koment, kjo është bërë qëllimshëm.

Te Urbanizimi realizimi për vitin 2024 është 1,300,000€ planifikimi për vitin 2025 bëhet 860,000€ ndërsa dalin me përqindje të realizimit me 152% ky është mashtrim fiskal.

Realizimi real është 1.39 % rritje ky është mashtrim që e kanë bërë këta zyrtarë kjo drejtori dhe kjo qeverisje.

Te Bujqësia 87,000€ të hyra në vitin 2024, planifikimi bëhet 15,000€ dhe realizimin në vitin 2025 tani del 64,000 €.

Te Shërbimet publike 111,000€ realizime për vitin 2024, planifikimi për vitin 2025 bëhet 30,000€ dhe realizimi në raport thotë se është 348%, ky është mashtrim fiskal.

Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë 87,900€ dhe mijëra euro për dreka e pije ndërsa për kompjuter, makina fotokopjuese e paisje speciale, mjekësore nuk e kemi të shpenzuar asnjë cent.

Uroj që në vitin 2026 me qeverisjen e re me drejtorët do të arrihen që të eliminohen këto defekte dhe mos provoni të mashtroni opinionin mos provoni të mbylleni kështu për opinionin sepse ne do të gjejmë forma për ta informuar drejt qytetarin se cila është ajo e vërteta e kësaj qeverisje.

Fitim Guda: te shërbimet e Gjeodezisë pasuritë jofinanciare këto zakonisht me çfarë motivacioni janë ulur në 500,000€ se këto zakonisht kanë qenë 2,500,000 kur në vitin e kaluar mbi 1,000,000 kemi pas shpronësime dhe këto mjete si duket i keni dedikuar tjera kah për projektet e tjera dhe në ghykatë keni paguar për punë të tjera.

Prandaj me cilin motivacion janë ulë nga 2,500,000 në 500.000 të lutem?

Sami Ahmeti: në shikim të parë ky projekt shihet sa është planifikuar mirë dhe është shpenzuar jashtëzakonisht mirë por në analizën financiare duke ju falënderuar punëtorëve që punojnë në DBF që pikë për pikë e kanë bërë analizën ashtu siç është edhe reale del se brendia është jashtëzakonisht e keqe dhe është shumë shqetësuese.

Nga 41,570,000€ do të thotë janë shpenzuar 39,364,000 do të thotë kanë mbet pa u shpenzuar 2,000,000€. Të paraqitura si obligime në programin e financave janë 3,000,000 ku për mua është shqetësuese dmth këto borxhe që kanë mbet pa u planifikuar.

Në kodin mallra dhe shërbime kanë qenë të planifikuara 7,482,000€ ndërsa janë shpenzuar 7,143,000€.

Në këto 3 kategori janë shpenzuar vendime gjyqësore 1 milionë e shërbime kontraktuese individuale 2,778,000€ dhe shërbime kontraktuese 732,000€.

I kam nxjerr edhe 48 zëra tjerë barnat, mirëmbajtja e shkollave, mirëmbajtja e veturave, naftë për derivate që punëtorët skanë mundëski me dal në teren janë shpenzuar 1,000,000 e e diçka 25.80%.

Te subvencionet vendimet gjyqësore janë paguar 661,000€ kanë mbet pa u shpenzuar 219,000€.

Te investimet kapitale vendime pa gjyqësore janë kryer vetëm 8.96% dmth është paguar ndërtesa e shkollës, janë paguar disa rrethoja, disa rrugë janë kryer dmth totali është 643,455€.

Vendimet gjyqësore për mua janë shqetësuese pse drejtoreët nuk i kanë zhvilluar procedurat por me vendime gjyqësore janë paguar urat pa u ndërtuar fare.

Te kanalizimet, te zërimi qe ky zërim që ne e kemi është detyruar pronari me e marr përmes gjykatës ku është defekti?

Çështja e bulevardit të qytetit bazuar në vendimin në ligjin nr.10L/002 të aprovuar nga qeveria e Kosovës mjetet të planifikuara si shpenzohen për bulevard deri në vitin 2025 deri në fund të vitit 2025 shpenzime për bulevard prej nivelit qendror 1,800,000€. Nga niveli lokal nga grantet qeveritare janë 490,000 e diçka shpenzime ndërsa nga të hyrat vetanake janë 1 milionë e diçka të shpenzuara deri në fund të vitit 2025.

Sipas vendimit të qeverisë së Kosovës total për bulevard janë shpenzuar 3,000,000 e diçka, të planifikuara për vitin 2026 janë 1,800,000€.

Muhadin Haziri: komuna e Gjilanit si autoritet kontraktues i këtyre kontratave me operator ekonomik më shumë është një barr e rolit ekzekutiv.

Sa i përket këtij planifikimi në raport deri te një kontratë qoftë projekt kapital apo investim i komunës nga buxheti unë mendoj se në këto rrethana pak është e dhimbshme kur i shohim vendimet gjyqësore.

Por edhe këto vendimet gjyqësore besoj se e kanë një përshkrim por mendoj se është barrë e ekzekutivit të komunës është një barrë e zyrës së projekteve, zyrës së prokurimit publik në Gjilan që në të ardhmen bile me mujtë me i eliminu këto procese edhe ne si legjislativ si anëtarë të kuvendit të bashkëpunojmë që të dalim nga situata që ti tejkalojmë këto vështirësi financiare.

Bajram Isufi-DBP

Një sqarim shtesë për këshilltarin Gagica në lidhje me buxhetin e DBP-së. Ne si drejtori e kemi një buxhet shtesë që na ka ardhur dmth vitet e fundit për shkak se ne e bëjmë shndërrimin e tokës bujqësore në ndërtimore dhe ne si drejtori nuk kemi mundësi me ditë sa tokë ka me shndërru brenda vitit prandaj aty ka luajt që është dallimi në mes planifikimit dhe realizimit në kuadër të DBP-së. Prandaj deshta ta sqaroj që ne nuk kemi mundësi me ditë që këtë vit sa ka me pas ndërtime dhe sa ka me pas shndërrim të tokës bujqësore në ndërtimore.

Abdyl Kastrati- DBF

Shumicën e pyetjeve do t'jua përcjelli me shkrim por dua tju pyes juve këshilltarëve komunal që keni qenë në mandatin e kaluar.

A e keni votuar buxhetin për vitin 2025 dhe qysh keni mujtë me i realizu investimet kapitale kur nuk keni pas buxhet, a e ndjeni veten fajtor për mosvotim të buxhetit?

Riad Rashiti: drejtor në fillim e thash që smundesh me dhanë përgjigje në disa çështje por në disa çështje të tjera edhe mundesh.

Por pyetjen që e bëre dola të përgjigjem a ndiheni fajtor për mosmiratimin e buxhetit pak më herët në fjalën tënde e the që viti 2025 e dimë të gjithë që është bazuar për shkak të mos miratimit ka qenë i planifikuar buxheti i vitit 2024 dhe ma thuaj ti sa është dallimi i investimit kapital që ka qenë në vitin 2024 me 2025 për atë pjesë të qetësisë skam qenë anëtar i kuvendit komunal por po mundem ta marr përgjegjësinë dhe të them po që 500,000€ janë planifikuar më shumë në vitin 2025 se në vitin 2024 dhe ne se kemi miratuar buxhetin dhe PDK-ja qenka fajtore e marr përgjegjësinë.

Më jep përgjigje sa ka qenë diferenca e planifikimit të buxhetit 2024/ 2025 për pasojat të cilat që po i ngrit?

Nëse paska pas kufizime buxhetore për investime kapitale qysh paska pas shfrenim të investimeve në mallra dhe shërbime në kontrata në vepër, në shërbime të luksit, të gjitha ato që kanë ndodhur në vitin 2025.

E di që të vetmin argument dhe të vetmen fjali me ju kundërvy opozitës në këtë rast PDK-së është me gjuajt fajin te pengesat që ju po i quani pengesa por jo absolutisht sepse buxhetin edhe po ta kishim miratu ne në vitin 2025 kuvendi i Kosovës më trego a e ka miratuar buxhetin dhe kur është miratuar nga buxheti i Kosovës?

Gentrit Murseli: kisha dashtë prej drejtorit që prej vitit 2026 kur është emëruar deri në përfundim të mandatit ta përfundoj punën me kompetencë profesionale.

Unë shpresoj që herave të tjera të jetë prezent kryetari i komunës që të kemi mundësi të ballafaqohemi me çështjet dhe bazën e të cilave ai ka përgjegjësi.

7. **Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronave të paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Kadrush Sylës nga Gjilani, Lagjja Dheu i Bardh-Gjilan**
8. **Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Hisnije Halimi nga Zhegra**
9. **Propozim vendimi për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës me pronën e paluajtshme të Nexhmedin Ibrahimimi nga Përlepnica**

Elijesa Rashiti-DGJKP

Diskutimi nuk është dëgjuar për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike.

Me 31 vota për miratohen pikat 7, 8 dhe 9 të Rendit të punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

11. Propozim për subvencionimin e punësimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Gjilanit

Krenare L. Kqiku: tani më lejoni që për pikën 11 të Rendit të punës me kërkesë të drejtoreshës ta largojmë që të punojmë më shumë rreth kësaj që të bëjmë më të mirën e mundshme në këtë kategori.

Me 31 vota për pika 11 largohet nga Rendi i punës.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

Shpend Nuhiu: atëherë unë propozoj të bëhet vendimi për caktimin e kompensimit të komisionit të aksionarëve lartësinë e pagesës ashtu siç ka qenë herën e kaluar.

Me 27 vota për miratohet propozimi për shumën e caktuar për komisionin e aksionarëve.

Në këtë proces votimi nuk ka marr pjesë Blerim Haziri.

12. Të ndryshme

Në pikën në të ndryshme nuk pati diskutime.

Procesmbajtësja:

Arbresha Ismaili- Hyseni

A. Hyseni



Kryesuesja e KK

Krenare Latif Kqiku

Krenare Latif Kqiku